



Lehtësimi për Përafrim me Acquis të BE

Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Nr. Identifikues i Projektit

EuropeAid/138565/DH/SER/XK

Nr. i Kontratës së Shërbimit 2018/395-320

**TREGTIA E SHËRBIMEVE TË KOSOVËS ME BE-n
DHE ANËTARËT E CEFTA-s**



Kontakt personat në
GFA Consulting Group GmbH janë

Z-sha Martina Bernauer (Drejtoreshë e Projektit)
Z. Luis Abugattas (Udhëheqës Ekipi)

Kosovë

**Mbështetje e Mëtutjeshme e Zhvillimit të Tregtisë
në Kosovë**

Numri i Kontratës 2018/395-320

Raport

Akt nr 2.2.8 - Tregtia e Shërbimeve të Kosovës me BE-n dhe Vendet Anëtare të CEFTA-s

Autorët:

Z. Luis Abugattas
Z-sha Shqipe Jashari Sekiraqa
Z-sha Xhorxhina Bami

Data: Maj 2020

Mohim

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Europian

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrogstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Tel: +49 (40) 6 03 06 170
Fax: +49 (40) 6 03 06 159
E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de

Përmbajtja

1. Hyrje	1
2. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës: Mjedisi Rregullator	3
2.1	MSA-ja 3
2.2	Marrëveshja e CEFTA-s 4
3. Tregtia Bilaterale e Shërbimeve të Kosovës me BE-n dhe CEFTA-n	6
3.1	Tregtia Bilaterale e Kosovës në Nën-sektorët e Shërbimeve Kryesore me Vendet Anëtare të BE-s 7
3.1.1	<i>Udhëtimi</i> 8
3.1.2	<i>Transporti</i> 13
3.1.3	<i>Shërbimet e Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK)</i> 16
3.1.4	<i>Shërbimet Tjera Afariste</i> 18
3.1.5	<i>Konkluzionet dhe Rekomandimet për Drejtimin e Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës me BE-n</i> 20
3.2	Tregtia e Kosovës në Nën-sektorët e Shërbimeve Kryesore me Palët e CEFTA-s 20
3.2.1	<i>Udhëtimi</i> 22
3.2.2	<i>Shërbimet tjera afariste</i> 23
3.2.3	<i>Shërbimet e Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK)</i> 24
3.2.4	<i>Konkluzionet dhe Rekomandimet për Tregtinë e Shërbimeve të Kosovës me Palët e CEFTA</i> 25
4. Konkluzionet Përmbyllëse	26
5. Shtojca 27	
5.1	Të Dhënat për Tregtinë e Shërbimeve me BE-n 27
5.1.1	<i>Tabela 1: Totali i Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 27
5.1.2	<i>Tabela 2: Shkëmbimet e Tregtisë së Udhëtimeve të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 28
5.1.3	<i>Tabela 3: Tregtia e Transportit të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 29
5.1.4	<i>Tabela 4: Shkëmbimet e Tregtisë së Ndërtimit me BE-n në milion EURO</i> 30
5.1.5	<i>Tabela 5: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Pensioneve dhe Sigurimeve të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 31
5.1.6	<i>Tabela 6: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve Financiare të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 32
5.1.7	<i>Tabela 7: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve TIK të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 33
5.1.8	<i>Tabela 8: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Tjera Afariste të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 34
5.1.9	<i>Tabela 9: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve Personale, Kulturore dhe Rekreative të Kosovës me BE-n në milion EURO</i> 35
5.1.10	<i>Tabela 10: Shkëmbimet e Qeverisë së Kosovës në Mallrat dhe Shërbimet n.i.e.</i>

	<i>me BE-n në milion EURO</i>	36
5.1.11	<i>Tabela 11: Shërbimet e prodhimtarisë së Kosovës për inputet fizike në pronësi të tjerëve me BE-n në milion EURO</i>	37
5.1.12	<i>Tabela 12: Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Riparimeve të Kosovës n.i.e. me BE-n në milion EURO</i>	38
5.1.13	<i>Tabela 13: Tarifat e Kosovës për shfrytëzimin e pronësisë intelektuale n.i.e. me BE-n në milion EURO</i>	39
5.2	<i>Të Dhënat për Tregtinë e Shërbimeve me Palët e CEFTA-s</i>	40
5.2.1	<i>Tabela 14: Shkëmbimet Totale të Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	40
5.2.2	<i>Tabela 15: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Prodhimtarisë për Inputet Fizike në Pronësi të Tjerëve me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	40
5.2.3	<i>Tabela 16: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Mirëmbajtjes dhe Riparimeve n.i.e. me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	41
5.2.4	<i>Tabela 17: Shkëmbimet e Tregtisë së Transportit të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	41
5.2.5	<i>Tabela 18: Shkëmbimet e Tregtisë së Udhëtimit të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	42
5.2.6	<i>Tabela 19: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Ndërtimit të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	42
5.2.7	<i>Tabela 20: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Pensioneve dhe Sigurimeve të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	43
5.2.8	<i>Tabela 21: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve Financiare të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	43
5.2.9	<i>Tabela 22: Tarifat e Kosovës për Shfrytëzimin e Transaksioneve të Tregtisë së Pronësisë Intelektuale me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	44
5.2.10	<i>Tabela 23: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve TIK të Kosovës me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	44
5.2.11	<i>Tabela 24: Shkëmbimet e Tregtisë së Shërbimeve të Tjera Afariste me Palët e CEFTA-s në milion EURO</i>	45

Tregtia e Shërbimeve të Kosovës me Vendet Anëtare të BE-s dhe CEFTA-s¹

1. Hyrje

Analizat e fundit të kryera nga Departamenti i Tregtisë së Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike të Kosovës (MEPTINIS), me ndihmën e Projektit të Bashkimit Europian “Mbështetje e Mëtuftjeshme Zhvillimit të Tregtisë në Kosovë (EUTSP)”, tregojnë se veprimtaritë e shërbimeve përbëjnë sektorin më të madh të ekonomisë së Kosovës, kontributi i të cilit në prodhimin e përgjithshëm të vlerës së shtuar vendase është në rritje të vazhdueshme.² Veprimtaritë e shërbimeve përbëjnë 72.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBP) në çmimet bazike në vitin 2018, dhe punësuan 85.3% të fuqisë punëtore. Përveç kësaj, sektori i shërbimeve përbën shumicën e bizneseve të themeluara në vend. Në vitin 2018, rreth 71.2% e bizneseve të regjistruara kohëve të fundit ishin në sektorin e shërbimeve.

Tregtia e shërbimeve³ është njëkohësisht shumë e rëndësishme për integrimin e Kosovës në ekonominë ndërkombëtare. Ndryshe nga rasi i tregtisë së mallrave ku Kosova shënon deficit të vazhdueshëm dhe në rritje; Kosova ka pasur suficit të vazhdueshëm në tregtinë e shërbimeve, e cila ka qenë vendimtare që të kontribuohet në financimin e pjesërishëm të llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave (BP). Në rastin e tregtisë totale të mallrave, importet totale përbëjnë 85% në këtë sektor. Në rastin e shërbimeve gjendja tërësisht ndryshon, me eksporte që përbëjnë 78.2% të tregtisë së përgjithshme në këtë sektor në vitin 2017, dhe 80.96% në vitin 2018. Prandaj, do të ishte e përshtatshme për politikëbërësit të zhvendosin fokusin dhe t'i japin përparësi më të lartë tregtisë së shërbimeve, si një shtytës i mundshëm i rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Është me rëndësi të theksohet se kjo është analiza e parë për drejtimin e tregtisë së shërbimeve të Kosovës. Dokumenti shqyrton strukturën dhe realizimin e tregtisë së shërbimeve të Kosovës me Bashkimin Europian (BE), dhe Palët e Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Mirëpo, duhet cekur se Zvicra, pas Gjermanisë në Evropë, është partneri i dytë më i madh i Kosovës në tregtinë e shërbimeve. Për shkak të mungesës së të dhënave të zëbërthyer në kategori për tregtinë e shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe secilit nga vendet anëtare të Marrëveshjes Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA), ky raport nuk përfshin vlerësimin e nevojshëm të atyre flukseve tregtare. Duhet të bëhen përpjekje të mëtejme në shqyrtimin e tregtisë së shërbimeve me vendet anëtare të EFTA-s.

Ky vlerësim mbulon vetëm vitet 2017 dhe 2018, sepse Banka Qendrore e Kosovës (BQK) i ka raportuar në Eurostat vetëm të dhënat për tregtinë e shërbimeve që nga viti 2017; i cili ka qenë burimi kryesor i të dhënave të shfrytëzuara. Kjo paraqet kufizim në studimin e tanishëm, i cili nuk mund të ofrojë një vështrim më të gjatë që do të mundësonte të kuptohen më mirë trendet kryesore dhe faktorët themelorë, të cilët shpjegojnë zhvillimin e drejtimit të tregtisë së shërbimeve të Kosovës. Të gjitha të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport mund të gjenden në Shtojcë. Ekziston një përqendrim i rëndësishëm regjional i tregtisë së shërbimeve në Kosovë. Pjesa më e madhe e tregtisë së shërbimeve të Kosovës zhvillohet me vendet anëtare të BE-s (28) dhe CEFTA-s. Në vitin 2017, 73.33 përqind e eksportit total të shërbimeve të Kosovës në mbarë botën u shënuan me vendet anëtare të BE-s dhe CEFTA-s. Kjo përqindje u rrit në 75.7 përqind në vitin 2018. Për më tepër, në vitin 2017, 69.85 përqind e importeve të përgjithshme të shërbimeve të Kosovës ishin me origjinë nga vendet e BE-s dhe CEFTA-s; dhe 61.44 përqind gjatë vitit 2018.

¹ Ky dokument është përgatitur me ndihmën e Projektit “Mbështetje e Mëtuftjeshme Zhvillimit të Tregtisë në Kosovë”, i financuar nga BE. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe GFA Consulting Group dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

² Referojuni “Ekonomia e Shërbimeve të Kosovës: Sfidat dhe Mundësitë për Rritje dhe Zhvillim të Qëndrueshëm”. Abugattas, Jashari-Sekiraqa, Simnica dhe Džudžević (21 dhjetor, 2018) GFA Consulting Group GmbH

³ Për këtë analizë ne përdorim kategoritë e tregtisë së shërbimeve të cilat i përcjellë Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për qëllime të Bilancit të Pagesave.

Ky raport përfshin tre nga katër modalitetet e ofertës së shërbimeve të identifikuara në Marrëveshjen e Përgjithshme të Tregtisë së Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT); e cila tani është përvetësuar si përkufizim i konsensusit të tregtisë së shërbimeve në të gjithë botën. Modaliteti i livrimit identifikohet në bazë të vendndodhjes fizike të ofruesit dhe konsumatorit në kohën e transaksionit. Që tregtia të konsiderohet nën modalitetin 1 duhet të jetë shkëmbim ndërkufitar, do të thotë se ofrohet nga njëri territor në tjetrin. Shërbimet e telekomunikimit, transportit dhe ato postare zakonisht përfshihen këtu. Modaliteti 2 i ofertës përfshin konsumin jashtë vendit, që do të thotë se një banor në një territor merr shërbimin në një territor tjetër. Shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë shërbimet më të zakonshme të përfshira në modalitetin 2 të ofertës.

Modaliteti 3 i ofrimit të shërbimeve bëhet me praninë komerciale. Kjo tregti zhvillohet kur ofruesi i shërbimit nga një territor themelon një degë në një vend të caktuar në territorin e vendit tjetër. Tregtia e shërbimeve nën këtë modalitet vlerësohet nga të ashtuquajturat të dhëna për Tregtinë e Shërbimeve të Filialeve të Huaja (FATS). Këto të dhëna nuk janë në dispozicion në rastin e Kosovës. Prandaj, ky raport nuk e përfshin tregtinë e shërbimeve në Modalitetin 3. Megjithatë, ky është modaliteti i ofertës në të gjithë botën përmes të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve; rreth 70 përqind e tërë tregtisë së regjistruar ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës, për shembull, ky modalitet i ofertës mbizotëron në rastin e shërbimeve financiare, ku bankat e huaja përfaqësojnë pjesën më të madhe të veprimtarisë financiare në vend. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave FATS duhet të përfshihen si detyrë kryesore në përpjekjet e ardhshme, të cilat synojnë përmirësimin e të dhënave për tregtinë e shërbimeve në Kosovë.

Modaliteti 4 është ofrimi i shërbimeve nga një territor në një tjetër përmes pranisë së pesonave fizik. Kategoritë e shërbimeve të ndërtimit dhe shërbimeve të tjera afariste zakonisht hyjnë në modalitetin 4 të ofertës me ndërtimtarët, konsulentët, avokatët, inxhinierët dhe profesionistët të tjerë nga çdo fushë të cilët mund të lëvizin dhe ofrojnë shërbime në një vend tjetër për veç vendit të tyre.

Ky raport është strukturuar si në vijim. Pjesa e dytë e këtij raporti shqyrton kornizën rregullatore të Kosovës për tregtinë e shërbimeve; e cila përgjithësisht ka krijuar një regjim relativisht liberal për tregti me ligjet e saj vendore dhe zotimet e përvetësuar ndërkombëtare. Pjesa e tretë ndahet në dy nën-pjesë që përkatësisht analizojnë tregtinë e shërbimeve me BE-n dhe tregtinë e shërbimeve me vendet anëtare të CEFTA-s. Analiza e tregtisë së shërbimeve me BE-n fokusohet në katër sektorë kryesorë – shërbimet e udhëtimeve, shërbimet tjera afariste, ato të transportit dhe shërbimet e Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK). Në rastin e tregtisë brenda CEFTA-s, është paraqitur një analizë më e hollësishme lidhur me tregtinë e shërbimeve të udhëtimeve, shërbimet tjera afariste dhe shërbimet TIK.

Mund të vërehet përqendrim i lartë sipas kategorisë dhe vendit, kryesisht për shkak të kontributit të diasporës (kryesisht në modalitetin e ofertës 2), i cili është shtylla e tregtisë së shërbimeve në Kosovë. Mosnjohja shpesh paraqet pengesë në zhvillimin e duhur të modalitetit 1 të ofertës dhe të drejtën e themelimit në modalitetin e ofertës 3 dhe praninë e personave fizik në modalitetin 4; mungesa e liberalizimit të vizave paraqet pengesë në modalitetet e ofertës 2, 3 dhe 4, por ajo gjithashtu kontribuon në suficitin tregtar në shërbimet e udhëtimit (modaliteti 2). Duke mos arritur akoma njohjen reciproke të kualifikimit profesional as me BE-n, por as me CEFTA-n, modaliteti 4 i ofertës nuk e ka arritur akoma potencialin e tij të plotë, megjithatë ai është kategoria e dytë më e madhe e tregtisë së shërbimeve, që nënkupton se është krijuar një bona fide⁴.

⁴ Nga latinishtja: mirëbesim

2. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës: Mjedisi Rregullator

Rregullimi i tregtisë së shërbimeve përbëhet nga dy organe të instrumenteve juridike të ndërlidhura ngushtë, të cilat së bashku parashikojnë kushtet në të cilat zhvillohet tregtia e shërbimeve: legjislacioni vendor dhe zotimet e përvetësuar në marrëveshjet tregtare, palë e së cilës është Kosova. Legjislacioni vendor përfshin normat horizontale, të cilat zbatohen për disa veprimtari të shërbimeve dhe ekzistojnë disa legjislacione sektoriale që rregullojnë ofrimin e shërbimeve të caktuara. Në shumë raste Kosova u jep trajtim kombëtar ofruesve të huaj dhe është një numër i kufizuar i kufizimeve sasiore, të cilat prekin ofruesit e huaj të shërbimeve. Në shumë raste, ende nuk ka rregullore, e cila rregullon ofrimin e disa veprimtarive të shërbimeve. MEPTINIS-i ka bërë përpilimin e të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve administrative që rregullojnë ofrimin e shërbimeve në vend; i cili do t'i nënshtrohej një auditimit rregullator për të vlerësuar nëse rregullorja është më e përshatshme ose do të nevojiteshin disa ndryshim/plotësime për të përmirësuar zhvillimin e shërbimeve në vend.

Kjo pjesë e raportit përqendrohet kryesisht në zotimet ndërkombëtare të përvetësuar nga Kosova në MSA dhe në Marrëveshjen e CEFTA-s dhe lidhjen e tyre me tregtinë e shërbimeve me ata partnerë. Në të dyja rastet, marrëveshjet përmbajnë detyrime normative materiale, si dhe zotimet procedurale dhe administrative, të cilat palët duhet t'i zbatojnë.

2.1 MSA -ja

Në MSA nuk ka zotime specifike sektoriale për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve, si të tilla. Zotimi kryesor i përvetësuar nga Kosova në kuadër të MSA-s⁵ është se legjislacioni vendor i Kosovës në përgjithësi duhet të jetë në pajtueshmëri me atë të BE-s. Në fushën e shërbimeve, ajo që është shumë e rëndësishme është detyrimi për transpozim të Direktivës së Shërbimeve (DSH) të BE-s,⁶ e cila pjesërisht është transpozuar me miratim të Ligjit të Shërbimeve në mars të vitit 2017.⁷ Ligji për Shërbime përfshin një numër të konsiderueshëm të veprimtarive të shërbimeve, por ka disa përjashtime të rëndësishme.⁸ Ligji garanton të drejtën e themelimit, e cila përfshin rreth 200 veprimtari të ndryshme të shërbimeve, që rregullojnë qasjen në treg për ofruesit e huaj të shërbimeve, dhënien e të drejtës së themelimit dhe parashikimin e rregullimit të procedurave administrative. Ky ligj, së bashku me Ligjin për Investime të Huaja, i cili parashikon trajtimin kombëtar për ofruesit e huaj që investojnë në Kosovë, ka hapur tregun për Modalitetin 3 në ato veprimtari të shërbimeve të përfshira në ligj.

⁵ MSA-ja është marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Europian, qëllimi i së cilës është të vendos marrëdhënie zyrtare dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve me perspektivën e anëtarësimit të Kosovës në BE. Përveç kësaj, synimi i MSA-s është të mbështes tranzicionin ekonomik të Kosovës, si dhe të përforcoj integrimin e saj në tregun e BE-s. Këshilli i BE-s miratoi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) midis BE-s dhe Kosovës me 22 tetor 2015. MSA-ja është nënshkruar në 27 tetor, 2015 në Strasburg. Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Ratifikimin e MSA-s me 2 nëntor, 2015 dhe ai hyri në fuqi në prill 2016.

⁶ Direktiva e Shërbimeve (DSH) 2006/123/EC e BE-s synon të lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve në tregun unik të BE-s. Duke qenë në përputhje me DSH të BE-s, Kosova do ta ketë më të lehtë që potencialisht të autorizohet që të angazhohet në tregtinë e shërbimeve me shtetet anëtare të BE-s, në përputhje me Kapitullin II të kësaj direktive.

⁷ Bashkë me Ligjin e Shërbimeve Nr. 05/L130, ligjet tjera vendore horizontale që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve përfshijnë Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt; Ligjin Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja; Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare; dhe Ligjin Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike. Këto ligje, bashkë me të gjitha ligjet e tjera, udhëzimet administrative dhe rregulloret e Kosovës, mund të gjenden në Gazetën Zyrtare të Kosovës në tri gjuhë zyrtare, shqip, serbisht dhe anglisht.

⁸ Neni dy i Ligjit për Shërbime thotë se ligji nuk zbatohet për rrjetet jo-ekonomike, financiare, komunikimin elektronik, rrjetin e përkohshëm, transportin e kujdesit shëndetësor, shërbimet mjekësore, audiovizuale, lojërat e fatit, asistencën sociale, ushtrimin e autoritetit zyrtar, sigurinë dhe pronën private, noterin dhe përmbartësin.

Në lidhje me zbatimin e Ligjit të Shërbimeve, është identifikuar se 54 instrumente juridike vendore, ligje dhe udhëzime administrative kanë nevojë për ndryshim/plotësim në mënyrë që Ligji për Shërbime të jetë në përputhje të plotë me Direktivën e Shërbimeve të BE-s. Për këtë detyrë është përpiluar programi i punës. Përveç kësaj, Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2018 për procedurën e njoftimit dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së projekt akteve normative me ligjin e shërbimeve është miratuar me 23 mars të vitit 2018, për të siguruar se çdo rregullore e re është në përputhje me dispozitat e ligjit. Më pas, Ligji për Shërbime parashikon që Kosova duhet të krijojë Pikën e Vetme të Kontaktit (PVK). Lidhur me këtë, qeveria ka miratuar gjithashtu me 23 mars 2018 Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2018, për mënyrën e funksionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK), i cili rregullon funksionalitetin e platformës shumëfunktionale elektronike për shërbime, qëllimi i së cilës është të lehtësohet qasja në tregun e Kosovës për ofruesit e shërbimeve. Është propozuar plan-programi për ta kryer këtë detyrë, e cila është shumë ambicioze dhe kërkon alokim të mjeteve të konsiderueshme.

MSA-ja përfshin edhe disa dispozita të përgjithshme të rëndësishme që lidhen me tregtinë e shërbimeve në Titulli V për "Themelimi, Ofrimi i Shërbimeve dhe Kapitali". Neni 51 përforcon parimin e trajtimit kombëtar dhe mosdiskriminimit, të cilët janë vendimtarë për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve. Neni 55, paragrafi 2 parashikon që stafi kyç i një kompanie të huaj, ata që zhvendosen brenda kompanisë, mund të jenë shtetas të një vendi nga origjina e kompanisë, duke lejuar kështu që shtetasit e Kosovës të mund të punojnë me lehtësi në kompanitë në pronësi të shtetasve të Kosovës në BE dhe të huajt të mund të punojnë me lehtësi në Kosovë në firmat që janë në pronësi të të huajve. Këtyre individëve do t'u lejohet të qëndrojnë në territorin e palës tjetër gjatë kohëzgjatjes së kontratave të tyre në përputhje me ligjet përkatëse. Në fund, MSA-ja përfshin një klauzolë shumë të rëndësishme të *pezullimit* përmes Nenit 59, i cili kërkon nga Palët të mos ndërmarrin asnjë masë apo veprim që vendos kushte për ofrimin e shërbimeve mjaft më kufizuese krahasuar me gjendjen ekzistuese në ditën që i paraprinë ditës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Më tej, MSA-ja përmban një agjendë mjaft të integruar që lidhet me tregtinë e shërbimeve. Neni 56 kërkon shqyrtimin e hapave të nevojshëm brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi për njohjen reciproke të kualifikimeve për të lehtësuar tregtinë e shërbimeve; ky shqyrtim ende nuk ka filluar. Neni 57, nga ana e tij, parashikon që gjashtë vjet nga hyrja në fuqi, SAC do të përcaktojë modalitetet për të zgjeruar dispozitat e saj për "shtetasit e BE-s dhe qytetarët e Kosovës me qëllim të hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm të ofruesve të shërbimeve, të themeluar si të vet-punësuar në territorin e një Pale dhe të cilët kanë lidhur një kontratë bona fide për të ofruar shërbime me konsumatorin final në atë Palë, duke kërkuar praninë e tyre të përkohshme tek ajo Palë në mënyrë që të përmbushin kontratën për të ofruar shërbime". Më tej, Neni 58 përcakton që pesë vjet nga hyrja në fuqi, palët ndërmarrin hapat e nevojshëm për të "lejuar gradualisht ofrimin e shërbimeve nga kompanitë e BE-s, kompanitë e Kosovës apo nga shtetasit e BE-s ose qytetarët e Kosovës që janë vendosur në territorin e një Pale, përveç të personit për të cilin synohen shërbimet".

Agjenda e integruar e MSA-s parasheh zhvillime të rëndësishme në të ardhmen në marrëdhëniet bilaterale që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve; prandaj për të përmirësuar tregtinë bilaterale të shërbimeve me BE-n, do të ishte e përshtatshme t'i jepej prioritet i nevojshëm kësaj agjende për tregtinë e shërbimeve dhe të programohet zbatimi i saj gradual. Disa nga zotimet tashmë të ndërmarrura nga palët në MSA, si dhe masat e ardhshme që do të dakordohen sipas agjendës së integruar, do të përfshijnë domosdoshmërisht lehtësimin e individëve që udhëtojnë përtej kufijve. Prandaj, eliminimi i pengesave për udhëtim të lirë duhet të përfshihet në mënyrë adekuate dhe të menjëhershme në çdo program pune, i cili ka për qëllim zbatimin e zotimeve të tanishme dhe të ardhshme të MSA-s që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve.

2.2 Marrëveshja e CEFTA-s

Në rastin e Marrëveshjes së CEFTA-s, zotimi drejt liberalizimit dhe lehtësimit të tregtisë së shërbimeve është përfshirë në pjesën kryesore të vet marrëveshjes, e cila në mesin e objektivave të saj ka zgjerimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve dhe lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve (Neni 1.c dhe d). Kjo do të arrihej me liberalizimin gradual dhe hapjen e ndërsjellë të tregjeve. Marrëveshja përfshinte një klauzolë zhvilluese në Nenin 29, e cila parasheh nisimën e negociatave me qëllim që të arrihet gradualisht një nivel i lartë i liberalizimit në përputhje

me Nenin V të GATS; dhe se zotimet e marra pas negociatave të tilla do të përcaktohen në plane (orare) të cilat do të jenë pjesë përbërëse e Marrëveshjes (Neni 29). Por, duhet theksuar se Marrëveshja e CEFTA-s përmbante detyrime të rëndësishme lidhur me investimet, si ndër të tjera trajtimin kombëtar dhe mosdiskriminimin (Neni 32), të cilat zbatoheshin për tregtinë e shërbimeve përmes Modalitetit 3 që nga hyrja e saj në fuqi. Për të ndërmarrë tërë koordinimin dhe veprimtaritë lidhur me tregtinë e shërbimeve, me vendim të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s është formuar Nën-Komiteti për Tregtinë e Shërbimeve⁹ në vitin 2015.

Një zhvillim shumë i rëndësishëm në kuadër të CEFTA-s ka qenë negociata dhe miratimi i Protokollit 6 për Tregtinë në Shërbime (PSH 6); përmes të cilit Anëtarët e CEFTA-s kanë bërë zotime të konsiderueshme, duke marrë zotime të veçanta, të cilat e kufizojnë liberalizimin e tregtisë në një gamë të gjerë të sektorëve të ndryshëm të shërbimeve dhe brenda secilit sektor në modalitete të ndryshme të ofertës.¹⁰ Kosova ka përfshirë zotime të rëndësishme për liberalizim në planin e saj të aneksuar në PSH 6.¹¹ Pas hyrjes në fuqi të PSH 6 dhe nëse zbatohet me sukses, edhe pse kryesisht e ka mbajtur status quo-n për rregullimin e tregtisë së shërbimeve, ai duhet të kontribuojë në rritjen e tregtisë ndër-rajonale të shërbimeve, sepse do të sigurojë parashikueshmërinë e kushteve në të cilat do të zhvillohet tregtia.

Një detyrim administrativ i cili rrjedh nga PSH 6 është krijimi i Pikës së Kontaktit për Shërbime (PKSH) në secilën nga palët pjesëmarrëse, së cilës i është besuar realizimi i detyrimeve të transparencës dhe njoftimit, të përfshira në PSH 6. PKSH-ja duhet të jetë në gjendje të ofrojë të gjitha informatat të cilat mund t'i kërkojë pala tjetër, dhe që menjëherë dhe në mënyrë adekuate të respektohen njoftimet e kërkuara me marrëveshje. Në Kosovë, PKSH-ja i është caktuar Departamentit të Tregtisë së MEPTINIS-it. Në bashkëpunim me EUTSP-n, Departamenti i Tregtisë aktualisht po punon në krijimin e bazës së të dhënave, e cila do të mbështes punën e PKSH-s. Ky është hapi i parë drejt krijimit të Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK), i cili do të jetë rezultati përfundimtar i avancimit gradual të PKSH-s. Krijimi i PKSH-s do të jetë shumë i rëndësishëm për Kosovën, sepse ajo do të mundësojë ofrimin efikas të të gjitha informatave dhe ndihmës së nevojshme për bizneset e shërbimeve për themelimin dhe operimin në vend dhe për lehtësimin e të gjitha procedurave të nevojshme administrative, të cilat do të mund të bëhen përmes internetit me një platformë të vetme elektronike, e cila do të lidhë të gjitha subjektet intervenuese publike dhe private me funksionin e miratimit dhe rregullimit të sektorëve të ndryshëm të shërbimeve në vend.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit regjional, me mundësi të konsiderueshme që të përmirësojnë tregtinë e shërbimeve kanë qenë përpjekjet për të arritur një marrëveshje midis BP 6 për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale (NRKP). Kanë filluar negociatat në këtë drejtim dhe raundi i parë i negociatave është mbajtur në dhjetor të vitit 2018. Janë identifikuar katër profesione të cilat ishin me interes për vendet pjesëmarrëse dhe ato janë përfshirë në negociata: mjekët, dentistët, arkitektët dhe inxhinierët. Deri në qershor të vitit 2019 janë mbajtur shtatë raunde të negociatave. Këtë proces e udhëhoqi RCC dhe Sekretariati i CEFTA-s. Kosova do të përfitonte shumë nga njohja reciproke e kualifikimeve profesionale me BP 6, duke pasur parasysh se dy Palët e CEFTA-s nuk e njohin shtetësinë e saj. Negociatat në këtë aspekt po vazhdojnë.

⁹ Më shumë informata mbi përgjegjësitë e Nën-Komitetit për Tregtinë e Shërbimeve mund të gjenden në web faqen e CEFTA-s (<https://cefta.int/structures/subcommittee-on-trade-in-services/#1464189451900-e423c71a-0456>)

¹⁰ PSH 6 u miratua në dhjetor 2020 nga palët e CEFTA-s dhe tani duhet të kalojë procedurat qeveritare për miratim.

¹¹ Referojuni "Vlerësimi i Detyrimeve të Kosovës që Dalin nga Protokollit Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve" nga Luis Abugattas

3. Tregtia Bilaterale e Shërbimeve të Kosovës me BE-n dhe CEFTA-n

Kjo pjesë e raportit analizon tregtinë bilaterale midis Kosovës dhe BE-s (28) dhe tregtinë midis Kosovës dhe palëve të CEFTA-s. Të dhënat për tregtinë e shërbimeve janë marrë nga EUROSTAT, ndërsa të dhënat për CEFTA-n u vënë në dispozicion përmes bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Kosovës, e cila është përgjegjëse për të regjistruar në bilancin e pagesave vlerën e eksporteve dhe importeve të shërbimeve. Siç u cekë në raportet e mëparshme, të punuara nga MEPTINIS-i me mbështetje të EUTSP-s, Kosova ka shumë punë për të bërë me qëllim që të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore për veprimtaritë e shërbimeve, pasi që mungesa e të dhënave është pengesë e vazhdueshme në arritjen e konkluzioneve adekuate dhe vlerësimin e modeleve të tregtisë. Analiza përballet edhe me kufizimin në arritjen e konkluzioneve lidhur me tendencat e vërejtura në tregtinë e shërbimeve në sektorë të caktuar, për shkak të periudhës së kufizuar kohore, e cila merret parasysh në këtë vlerësim, vetëm vitet 2017 dhe 2018. Të gjitha të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport mund të gjenden në Shtojcë.

Pjesa më e madhe e tregtisë së shërbimeve të Kosovës zhvillohet me BE-n dhe anëtarët e CEFTA-s, prandaj është e rëndësishme të shqyrtohet përbërja e tregtisë së tillë me ata partnerë. Në të ardhmen kur do të ketë të dhëna më afatgjata, do të mund të kuptohen më mirë përcaktuesit dhe perspektiva e tregtisë së shërbimeve me ato vende; gjë që do të ofrohet njohuri e rëndësishme për formulimin e politikave. Duhet theksuar gjithashtu se përveq përqendrimit të lartë gjeografik të tregtisë së shërbimeve të Kosovës, ka edhe përqendrim të lartë në llogarinë e udhëtimeve, të cilat shënojnë shpenzimet e jo-rezidentëve deri sa janë territorin e Kosovës. Udhëtimet përbëjnë edhe një pjesë të konsiderueshme të tregtisë së shërbimeve me vendet anëtare të BE-s dhe CEFTA-s; në veçanti sa i përket eksporteve të shërbimeve.

Në rastin e Kosovës, ekziston një lidhje e ngushtë midis vendit të banimit të diasporës dhe tregtisë së shërbimeve të udhëtimit. Popullsia totale e Kosovës është 2,231,000; 400,000 prej të cilëve janë regjistruar se qëndrojnë dhe janë aktiv jashtë vendit. Ish Ministria e Diasporës, e cila tani është pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) analizoi të dhënat e 342,803 anëtarëve të regjistruar të diasporës për të qenë në pajtueshmëri me Regjistrin e Diasporës në vitin 2017. Përkundër nivelit të lartë të eksporteve në shërbimet e udhëtimit, duket se burimi kryesor i të ardhurave vjen nga vizitat familjare nga diaspora e Kosovës, të cilët kryesisht jetojnë në BE dhe në Zvicër, vend i cili nuk është përfshirë në këtë raport. Burim tjetër i të ardhurave janë vizitat në familje dhe tek të afërmit nga regjioni për shkak të lidhjeve historike dhe afërsisë.

Regjistri i Diasporës është përdorur në këtë raport për të kuptuar më mirë lidhjen midis diasporës dhe shërbimeve të udhëtimit në Kosovë, duke shqyrtuar lidhjen e vendit të banimit dhe fluksin e shërbimeve të udhëtimit. Duhet theksuar se në vitin 2018, ka pasur 4.707.785 vizita në Kosovë nga njerëzit që jetojnë jashtë vendit: 227,203 më shumë se në vitin 2017. Duhet cekur se një person mund ta vizitojë vendin më shumë se një herë në vit, siç është rasti me anëtarët e diasporës, të cilët në 70 përqind të rasteve e vizitojnë Kosovën më shumë se një herë në vit. Rreth 75.33 përqind në vitin 2018 u regjistruan si vizita miqëve dhe të afërmeve, pothuaj 2 përqind më shumë se në vitin 2017. Nga këto vizita të regjistruara si vizitë miqve dhe të afërmeve, vetëm rreth 8 përqind ishin nga njerëzit që vijnë nga BE-ja dhe rreth 84.3 përqind nga shtetet anëtare të CEFTA-s. Mirëpo, të ardhurat kryesore nga eksporti i shërbimeve të udhëtimit realizohen nga BE-ja dhe Zvicra. Gjetjet sugjerojnë se numri i vizitorëve nuk duhet të shndërrohet domosdoshmërisht në të ardhura nga udhëtimi.


3.1 Tregtia Bilaterale e Kosovës në Nën-sektorët e Shërbimeve Kryesore me Vendet Anëtare të BE-s¹²

Në përgjithësi, Kosova regjistron suficit në tregtinë e shërbimeve me BE-n, i cili është rritur që nga viti 2017. Në vitin 2017, suficiti i tregtisë së shërbimeve në Kosovë me BE-n ishte EURO 717.3 milion, ndërsa në vitin 2018 është rritur ndjeshëm për EURO 49.5 milion. Eksportet e shërbimeve në BE në vitin 2018 arritën në EURO 968.5 milion, që është EURO 62.7 milion më shumë se në nivelin e vitit 2017. Importet e shërbimeve të Kosovës nga BE-ja në vitin 2018 arritën në EURO 201.7 milion, duke u rritur ndjeshëm në shumën prej EURO 13.2 milion krahasuar me vitin paraparak. Kontribuesi kryesor në eksportet e shërbimeve të Kosovës në BE janë shërbimet e udhëtimit, të cilat përbënin rreth 81.16 përqind të totalit të eksporteve të shërbimeve në vitin 2018. Në rastin e importeve, tregtia është shumë më e larmishme, me udhëtimet që përfaqësojnë vetëm në mesatare 21 përqind të totalit të importeve të shërbimeve nga BE-ja gjatë dy vjetëve të shqyrtuara.

Kjo pjesë analizon tregtinë e shërbimeve të Kosovës me BE-n. Mund të vërehet përqendrim i lartë sipas vendit dhe veprimtarisë; me tregtinë e shërbimeve që kryesisht zhvillohet në disa kategori dhe me vetëm disa vende anëtare të caktuara të BE-s.

Gjatë periudhës së analizuar, katër shërbime përbëjnë një pjesë të madhe të eksporteve të shërbimeve të Kosovës në BE: shërbimet e udhëtimit, transportit, TIK-ut dhe shërbimet tjera afariste. Këto shërbime përfaqësuan në vitin 2018, 94.3, përqind të totalit të eksporteve të shërbimeve të Kosovës në BE. Sa i përket importeve, këto shërbime përbënin 77.4 përqind të totalit të importeve të shërbimeve të Kosovës nga BE-ja. Tregtia me BE-n në kategoritë e shërbimeve tjera është mjaft e kufizuar.

¹² Kjo pjesë do të analizojë tregtinë e shërbimeve të Kosovës në nën-sektorët kryesor me Mbretërinë e Bashkuar (MB). MB-ja doli nga BE-ja më 31 janar, 2019, mirëpo ajo është ende pjesë e marrëveshjeve tregtare të nënshkruara nga BE-ja deri në fund të vitit 2020.



Skica 1: Transaksionet e tregtisë së shërbimeve të Kosovës me shtetet anëtare të BE-s përfshirë MB-n), për 2017-2018. Burimi: EUROSTAT. Elaborimi nga autorët.

3.1.1 Udhëtimi

Kjo pjesë shqyrton shërbimet e udhëtimit të Kosovës me BE-n. Udhëzimi është modaliteti 2 i ofertës. Eksportet e udhëtimit regjistrojnë shpenzimet brenda territorit të Kosovës nga jo-rezidentët gjatë vitit përkatës. Ai përfshin vizitorët për qëllime turizmi, biznesi dhe për arsimim ose për qëllime shëndetësore. Llogaria përfshin shpenzimet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë siç janë hotelet, restorantet, transporti, shitja me pakicë dhe ndër të tjera, institucionet arsimore dhe shëndetësore. Importet e udhëtimit regjistrojnë llojin e njëjtë të shpenzimeve, por të kosovarëve që jetojnë jashtë vendit.

Udhëtimi është gjeneruesi kryesor i suficitit të tregtisë së shërbimeve në ekonominë e Kosovës, i cili zvogëlon kështu deficitin e përgjithshëm të qëndrueshëm tregtar të vendit. Përkundër vlerës së lartë të eksporteve brenda këtij sektori të shërbimeve, ai nuk është domosdoshmërisht rezultat i një sektori të zhvilluar të turizmit, por i besnikërisë së diasporës.


Udhëtimi përbënte 77.6 përqind të Totaliit të eksporteve të shërbimeve të Kosovës gjatë vitit 2018, duke regjistruar një total të suficitit tregtar prej EURO 851.7 milion në atë vit. Gjatë vitit 2018, shërbimet e udhëtimit kontribuan me 97.3 përqind të suficitit të përgjithshëm tregtar të Kosovës në tregtinë e shërbimeve me BE-n. Shërbimet e Kosovës me BE-n në kategorinë e udhëtimit, eksporteve në botë, vizitorëve për turizëm, që është udhëtim personal, gjenerojnë një pjesë dërrmuese të faturave të udhëtimit të Kosovës dhe shpjegojnë suficitin tregtar, të regjistruar në këtë sektor. Aktualisht nuk ka të dhëna të zbërthyer në kategori për shërbimet e udhëtimit midis Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-s sipas kategorive të ndryshme që i përfshin.

Kosova ka eksportuar në BE një total prej EURO 786 milion në shërbimet e udhëtimit në vitin 2018, duke pësuar një rritje prej 13.3 milion EURO krahasuar me vitin 2017. Eksportet e larta në sektorin e udhëtimit zakonisht mund t'i atribuohen investimeve strategjike ose besnikërisë së diasporës.

Kur dihet se nuk ka Strategji Kombëtare për Turizëm në Kosovë, por vetëm strategji në nivel komunal në disa komuna, si Prishtina dhe Prizreni, duket se arsyeja për suficitin tregtar në sektorin e shërbimeve të udhëtimit është diaspora besnike. Mirëpo, kontributi i përgjithshëm i shërbimeve në eksportin e tregtisë së shërbimeve në Kosovë me BE-n në vitin 2018 ka rënë për 14.4%, krahasuar me vitin 2017.

Importet e shërbimeve të udhëtimit të Kosovës në vitin 2018 nga BE-ja gjithashtu pësuan një ulje të lehtë të porosisë prej EURO 3.1 milion krahasuar me vitin 2017. Arsyeja kryesore për shkallë relativisht të ulët të importeve të shërbimeve të udhëtimit mund të jenë kufizimet me të cilat përballen shtetasit e Kosovës për të udhëtuar në BE, siç janë vizat që nevojiten për të udhëtuar në shumicën e vendeve anëtare të BE-s. Edhe mosnjohja nga disa vende të caktuara, e cila kontribuon në eksport të lartë në këtë llogari, shkakton një pjesë të konsiderueshme të suficitit në tregtinë e shërbimeve. Gjatë vitit 2018, Kosova ka pësuar rritje në suficitin e tregtisë së shërbimeve të udhëtimit me BE-n prej EURO 15.9 milion, si rezultat i uljes së porosisë prej EURO 2.6 milion të importeve të këtyre shërbimeve dhe një rritje të njëkohshme prej 13.3 milion në eksportet e shërbimeve të udhëtimit. Suficiti tregtar arriti në EURO 851.7 milion, nga EURO 842.3 milion në vitin 2017. Skica 2 paraqet të dhënat e tregtisë së shërbimeve të udhëtimit me shtete të caktuara anëtare të BE-s.

Kjo pjesë do të argumentojë se eksporti i lartë në shërbimet e udhëtimit, që kryesisht shpjegon suficitin tregtar në tregtinë e shërbimeve me BE-n, ndodh kryesisht për shkak të vizitave të diasporës që i bëhen miqve dhe familjeve të tyre, si dhe vështirësive në marrjen e vizës së nevojshme që të udhëtohet përkohësisht në BE, gjë e cila do të mund të kufizonte mjaft importet e udhëtimeve nga Kosova. Një çështje e cila sfidon vlerësimin e duhur të diasporës së Kosovës është ekzistenca si e: shtetësisë së dyfishtë, individët që kanë shtetësinë kosovare, edhe të vendit ku qëndrojnë jashtë vendit; ashtu edhe mungesën e shtetësisë kosovare. Kjo e fundit është e zakonshme, për shkak se Kosova e ka shpallur pavarësinë e saj tek në vitin 2008, duke krijuar kështu pengesa për të aplikuar dhe për t'iu dhënë shtetësia kosovare shtetasit që jeton jashtë vendit.



Skica 2: Tregtia e shërbimeve të udhëtimit të Kosovës me vendet anëtare të BE-s (përfshirë Mbretërinë e Bashkuar), në 2017-2018. Burimi: EUROSTAT


Kjo pjesë do të analizojë shkëmbimet e tregtisë së udhëtimit të Kosovës duke përdorur të dhënat nga Rezultatet Paraprake të Regjistrimit të Diasporës, të bërë nga ish MPJD, kështu që do të shqyrtohen gjithsej 342,803 shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, si anëtarë të diasporës. Sipas Regjistrimit të Diasporës së Kosovës në vitin 2016 ishin 400,000 qytetarë të Kosovës që jetojnë dhe janë aktiv jashtë vendit dhe MPJD ka analizuar të dhënat e 342,803 personave, pa 57,197 anëtarë të regjistruar të diasporës së Kosovës. Të dhënat nga MPJD, tregojnë se rreth 226,216 shtetas të Kosovës jetojnë në BE, rreth 66 përqind e diasporës së Kosovës.

Duhet theksuar se diaspora e Kosovës mund të jetë rritur dhe është më e madhe në numër se numri zyrtar në raportin e MPJD -s, për arsye të ndryshme. E para, në raportin e Regjistrimit të Diasporës është marrë parasysh vetëm diaspora me origjinë shqiptare. E dyta, raporti është bërë tre vjet më parë. E treta, sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), diaspora e Kosovës përbëhet nga 800,000 njerëz. Për shkak të mungesës së të dhënave tjera të zberthyer, ky raport do të shfrytëzojë analizën e MPJD-s.

Në vitin 2018, rreth 304,556 persona, nga 4,707,785 që e vizituan Kosovën, janë regjistruar si udhëtime për të vizituar miq dhe të afërm. Numri i vizitorëve të regjistruar si udhëtime për të vizituar familjet dhe miqtë në vitin 2018 që kanë hyrë nga BE-ja, ishte 265,372, vetëm 17% më shumë se numri i diasporës së regjistruar që jetojnë në BE. Numri i hyrjeve për vizitë familjeve dhe miqve nga BE-ja në Kosovë është rritur për 39,184 në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017.

Skica 3 në vijim tregon eksportet e shërbimeve të udhëtimit në vitin 2018, me shtetet anëtare të BE-s me shpeshësinë më të lartë të regjistruar në vitin 2016 të cilët jetojnë dhe janë aktiv në ato

vende. Ajo në veçanti paraqet totalin e eksporteve të shërbimeve të udhëtimit,¹³ udhëtimit tek familjet dhe miqtë në Kosovë,¹⁴ dhe rezidentët e diasporës,¹⁵ të Gjermanisë, Italisë, Austrisë dhe Francës, të shprehura në përqindje të vlerësimit të përgjithshëm të të njëjtave kategori me Bashkimin Evropian në tërësi. Në skicë mund të shihet se vendet pothuajse përkojnë, që nënkupton lidhjen direkte midis diasporës që jeton në shtete të caktuara anëtare të BE-s dhe të ardhurat nga udhëtimet e regjistruara në Kosovë me origjinë nga këto shtete të caktuara. Të dhënat tregojnë gjithashtu një përqendrim të lartë sipas vendit me pjesën më të madhe të tregtisë në udhëtime, në vitin 2017 dhe 2018, e cila zhvillohet me Gjermaninë, Italinë, Austrinë dhe Francën. Tregtia e shërbimeve të udhëtimit me këto vende do të analizohet më hollësisht.



Skica 3: Drejtimi i eksporteve në shërbimet e udhëtimit me vendet anëtare të BE-s, të cilat kanë shpeshësinë më të lartë të rezidentëve të diasporës brenda BE-s. Burimi: EUROSTAT, Dogana e Kosovës, Regjistri i Diasporës i Kosovës.

1. Gjermania

Eksportet e udhëtimit të Kosovës me Gjermaninë përbënin në vitin 2018 EURO 364.8 milion, ose 46.4 përqind të totalit të eksportit në tregtinë e shërbimeve. Krahasuar me vitin 2017, mund të shihet një rënie prej 2.5 milion EURO. Kosova ka importuar një shumë prej 6.8 milion EURO në shërbime të udhëtimit nga Gjermania në vitin 2018, me një rënie prej 600 mijë EURO, krahasuar me vitin 2017. Suficiti tregtar në tregtinë e shërbimeve të udhëtimit me Gjermaninë ishte EURO 358 milion në vitin 2018, dhe me një rënie në suficitin tregtar prej 19 milion EURO, krahasuar me vitin 2017, për shkak të rënies së njëkohshme, si në eksportet, ashtu edhe importet e shërbimeve të udhëtimit.

¹³ Të dhënat e vitit 2018 nga Banka Qendrore e Kosovës.

¹⁴ Të dhënat e vitit 2018 nga dogana e Kosovës.

¹⁵ Të dhënat e vitit 2016 nga Regjistri i Diasporës së Kosovës.

Sipas ish Ministrisë së Diasporës, 36.77% e tërë diasporës së Kosovës jeton në Gjermani, që do të thotë se 55.7% të Diasporës të cilët qëndrojnë në BE, jetojnë në Gjermani. Përveç kësaj, rreth 41.8% e njerëzve që hynë në Kosovë në 2018 nga BE për të vizituar familjet dhe miqtë, ishin nga Gjermania. Në vitin 2017, kjo përqindje ishte pak më e ulët me 36.3% të individëve që hynë nga BE-ja për të vizituar familjet dhe miqtë ishin nga Gjermania. Pra, shumica e eksporteve të udhëtimit të Kosovës në Gjermani është realizuar nga diaspora. Pasi 60.5% e hyrjeve nga Gjermania në Kosovë në vitin 2018 dhe rreth 58.23% në vitin 2017 kanë qenë vizita familjarëve dhe miqve, mund të konkludohet se eksporti kryesor i shërbimeve të udhëtimit të Kosovës me Gjermaninë vjen nga besnikëria e diasporës ndaj Kosovës.

II. Austria

Eksportet e udhëtimit të Kosovës në Austri në vitin 2018 përbënin EURO 91.4 milion, ose 11.63% të totalit të eksportit të tregtisë së shërbimeve. Mund të vërehet rritje prej 2.8 milion krahasuar me vitin 2017. Kosova ka importuar një shumë prej 2.4 milion EURO në shërbimet tregtare nga Austria në vitin 2018, me një rënie të ulët prej 0.3 milion EURO, krahasuar me vitin 2017. Suficiti në tregtinë e shërbimeve të udhëtimit me Austrinë ka arritur në EURO 89 milion në vitin 2018, ku shihet një rritje në suficitin tregtar prej 3.1 milion EURO, krahasuar me vitin 2017; në parim, për shkak të rënies në importe dhe rritjes në eksporte gjatë vitit 2018.

Sipas ish Ministrisë së Diasporës, 4.3% e tërë diasporës së Kosovës qëndrojnë në Austri, që do të thotë se rreth 6.5% e Diasporës që qëndrojnë në BE, jetojnë në Austri. Përveç kësaj, rreth 12.7% e njerëzve që hynë në Kosovë në vitin 2018 nga BE-ja për vizitë familjeve dhe miqve, ishin nga Austria. Në vitin 2017, kjo përqindje ka rënë krahasuar me vitin 2017 kur 13.4% e hyrjeve nga BE-ja për të vizituar familjet dhe miqtë ishin nga Austria. Pra, pjesa më e madhe e eksporteve të udhëtimit në Kosovë nga Austria vjen nga diaspora. Rreth 75.5% e hyrjeve nga Austria në Kosovë në vitin 2018 dhe rreth 71.3% në vitin 2017 kanë qenë vizita familjarëve dhe miqve, prandaj mund të konkludohet se eksporti kryesor i shërbimeve të udhëtimit të Kosovës me Gjermaninë është bërë nga diaspora.

III. Italia

Eksportet e udhëtimit të Kosovës në Itali në vitin 2018 përbënin EURO 34.3 milion, ose 4.36% të totalit të eksportit të tregtisë së shërbimeve. Mund të vërehet një rënie prej 1.1 milion EURO krahasuar me vitin 2017. Kosova ka importuar një shumë prej 2.4 milion EURO në shërbimet tregtare nga Italia në vitin 2018, me një rënie prej 1 milion EURO krahasuar me vitin 2017. Suficiti në tregtinë e shërbimeve të udhëtimit me Italinë është EURO 70 milion në vitin 2018, me një rritje në suficitin tregtar prej 0.4 milion EURO, krahasuar me vitin 2017, për shkak të rënies më të lartë në importe se sa në eksporte.

Sipas ish Ministrisë së Diasporës, rreth 5% e tërë diasporës së Kosovës jeton në Itali, që do të thotë se rreth 7.5% e diasporës që qëndron në BE, jeton në Itali. Përveç kësaj, rreth 5.5% e njerëzve që hynë në Kosovë në vitin 2018, nga BE-ja për të vizituar familjet dhe miqtë, ishin nga Italia. Përqindja nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2017, mirëpo numri i hyrjeve nga Italia për të vizituar familjet dhe miqtë është rritur për 2,095 hyrje. Pra, pjesa më e madhe e eksportit të udhëtimit në Kosovë nga Italia vjen nga diaspora. Rreth 62.7% e hyrjeve nga Italia në Kosovë në vitin 2018, dhe rreth 59.5% në vitin 2017 kanë qenë vizita familjeve dhe miqve, prandaj mund të konkludohet se eksporti kryesor i shërbimeve të udhëtimit të Kosovës me Italinë është bërë nga diaspora.

IV. Franca

Eksportet e udhëtimit të Kosovës në Francë në vitin 2018 përbënin EURO 72.4 milion, ose 9.2% të totalit të eksportit të tregtisë së shërbimeve. Mund të vërehet një rënie prej 0.1 milion EURO krahasuar me vitin 2017. Kosova ka importuar një shumë prej EURO 1.6 milion në shërbimet e udhëtimit nga Franca në vitin 2018, me rënie të paktë prej 0.3 milion EURO krahasuar me vitin 2017. Suficiti në tregtinë e shërbimeve të udhëtimit me Francën është EURO 32.7 milion në vitin

2018, me një rënie në suficitin tregtar prej 0.4 million EURO, krahasuar me vitin 2017, për shkak të rënies së njëkohshme, por diferencuese, si në eksportet, ashtu edhe importet e shërbimeve të udhëtimit.

Sipas Ministrisë së Diasporës, rreth 3.8% e tërë diasporës së Kosovës jetojnë në Francë, që do të thotë se rreth 5.7 % e Diasporës që qëndrojnë në BE, jetojnë në Francë. Përveç kësaj, rreth 5.6% e njerëzve që hynë në Kosovë në vitin 2018 nga BE-ja për vizitë familjeve dhe miqve, ishin nga Franca, 0.1% më pak se në vitin 2017, por 1,894 më shumë persona. Pra, pjesa më e madhe e eksporteve të udhëtimit në Kosovë nga Franca vjen nga diaspora. Rreth 58.4% e hyrjeve nga Franca në Kosovë në vitin 2018 dhe rreth 53.5% në vitin 2017 kanë qenë vizita familjarëve dhe miqve.

Analiza paraprake qartë sugjeron se në rastin e tregtisë midis Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-s në shërbimet e udhëtimit, turizmi tradicional nuk po kontribuon mjaft në ekonominë e Kosovës; sepse eksportet kryesisht shpjegohen nga udhëtimet hyrëse të anëtarëve të diasporës. Kjo pjesë analizoi të dhënat nga 4 shtete anëtare të BE-s ku ka prani të konsiderueshme të diasporës. Mirëpo, skica 4 tregon se të dhënat e zberthyer në kategori lidhur me eksportet e shërbimeve të udhëtimit të Kosovës në BE si tërësi paraqesin një model të ngjashëm. Të dhënat për rezidentët e diasporës së Kosovës në BE pothuajse përkojnë me hyrjet për vizitë familjeve dhe miqve nga BE-ja dhe me eksportet e shërbimeve të udhëtimit të Kosovës në Bashkim Evropian.

Kosova është në proces të hartimit të strategjisë kombëtare për turizëm. Deri më tani, turizmi i vendit ka mbijetuar në bazë të strategjive të turizmit në nivel lokal, të realizuara nga projekte të ndryshme ndërkombëtare në bashkëpunim me komuna të caktuara, siç është komuna e Prishtinës dhe Prizrenit. Mosekzistimi i strategjisë kombëtare për turizëm ka shumë implikime negative për tregtinë e shërbimeve të udhëtimit. Aktualisht, faturat e udhëtimit janë shtylla e tregtisë së shërbimeve të Kosovës, si me botën, ashtu edhe me BE-n. Mirëpo, vendi nuk mundet gjithmonë të mbështetet në diasporën besnike, pasi shkalla e lidhjes me vendin e origjinës ka tendencë të zbehet me më shumë gjenerata të lindura dhe të rritura jashtë vendit. Prandaj, politikbërësit duhet t'i japin përparësi investimeve strategjike në sektorin e turizmit për të zhvilluar më tej turizmin tradicional me qëllim që të tërheq shtetasit e huaj për të vizituar Kosovën dhe për të fituar besimin e turistëve, i cili do të përmirësojë gjithashtu imazhin e vendit jashtë shtetit.

3.1.2 Transporti


Sipas Doracakut për BeP, shërbimet e transportit përfshijnë metoda të ndryshme të transportimit, ku përfshihet transporti ajror, tokësor dhe detar, si i mallrave, ashtu edhe udhëtarëve. Sektori i transportit përfshin edhe shërbimet plotësuese në të gjitha mënyrat e transportit, siç janë shërbimet e trajtimit të ngarkesave, shërbimet për ruajtje dhe magazinim, shërbimet e agjencive për transportim të mallrave, përfshirë shërbimet tjera ndihmëse të transportit (kompensimi për ndërmjetësim të ngarkesës; auditimi i faturave dhe informatat mbi tarifën e ngarkesave; përgatitja e dokumentacionit për transportim; paketimi dhe shpaktimi; inspektimi i ngarkesës, peshimi dhe marrja e mostrave; dhe marrja dhe pranimi i ngarkesës). Kjo pjesë analizon tregtinë e shërbimeve të udhëtimit të Kosovës me Bashkimin Evropian duke analizuar tregtinë me shtete të caktuara anëtare të BE-s.

Kosova ka shënuar bilancin më të lartë negativ në tregtinë e shërbimeve në shërbimet e transportit. Në vitin 2018 Kosova ka importuar EURO 68.2 milion të shërbimeve të transportit nga BE-ja dhe ka eksportuar EURO 24.5 milion. Eksportet e shërbimeve të transportit të Kosovës në BE të paraqitura në vitin 2018, 58.6 përqind e totalit të eksporteve të këtyre shërbimeve në botë. Njëkohësisht, 53.7 përqind të importeve totale. Prandaj, BE-ja është partner i rëndësishëm i këtyre shërbimeve. Eksportet e shërbimeve të transportit të Kosovës në BE u rritën për EURO 5.6 milion në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, ndërsa importet shënuan një rritje më të lartë në vitin 2018, për EURO 6.9 milion. Kjo ka bërë që deficitin e Kosovës në këto shërbime të rritet ndjeshëm nga e njëjta periudhë e vitit paraprak.

Tregtia e shërbimeve të transportit lidhet ngushtë me tregtinë e mallrave; sepse transporti i ngarkesave paraqet pjesën më të madhe të transaksioneve të këtyre shërbimeve. Llogaritë e shërbimeve të transportit paraqesin kryesisht shtetësinë e ofruesve të këtyre shërbimeve. Gjendja

e Kosovës pa dalje në det ndikon mjaft në tendencat e vërejtura në tregtinë e përgjithshme të shërbimeve të transportit. Për më tepër, në mungesë të një transportuesi kombëtar, transporti ajror përbën 23.1 përqind shtesë të totalit të importeve të shërbimeve të transportit të Kosovës. Në këtë rast, eksportet e transportit ajror janë kryesisht faturat nga shërbimet që u ofrohen transportuesve të huaj në territorin e Kosovës.


Importet e shërbimeve të transportit të Kosovës nga BE-ja përqendrohen në gjashtë shtete anëtare të BE-s, të cilat përbëjnë 63.3 përqind të të gjitha importeve nga ajo origjinë.¹⁶ Ekziston një lidhje e ngushtë midis importeve të shërbimeve të transportit dhe pranisë së një diaspore të rëndësishme, e cila përfshin transportin e udhëtarëve, si dhe tregtinë e mallrave, e cila pasqyron transportin e ngarkesave. Në rastin e eksporteve të shërbimeve të transportit të Kosovës në BE, tri vende: Gjermania, MB-ja dhe Qiproja përbëjnë 83 përqind të eksporteve totale. Tregtia e shërbimeve të transportit me anëtarë të caktuar të BE-s është paraqitur në skicën 5. Të dhënat mund të gjenden në Tabelën 3 të Shtojcës.



Skica 4: Tregtia e shërbimeve të transportit të Kosovës me shtetet anëtare të BE-s (përfshirë MB), në 2017-2018. Burimi: EUROSTAT

¹⁶ Gjermania, Italia, Greqia, Sllovenia, Rumania, dhe MB-ja.

Është me rëndësi të theksohet se Kosova ka shënuar një bilanc pozitiv tregtar në shërbimet e transportit në vitin 2018 vetëm me Belgjikën (Euro 0.5 milion), Irlandën (Euro 0.5 milion), Mbretërinë e Bashkuar (EURO 3.2 milion), dhe çuditërisht me Qipron (EURO 0.5 milion). Mund të vërehet rritje në tregtinë e Kosovës me secilën nga ato vende, me përjashtim të Belgjikës krahasuar me vitin 2017, siç shihet në skicën 6 në vijim.



Skica 5: Shkëmbimet e tregtisë së transportit të Kosovës me shtetet anëtare të BE-s, ku ajo ka pësuar një suficit tregtar në vitin 2018 (përfshirë MB-n), (në milion Euro). Burimi: EUROSTAT

Nuk ka të dhëna të zërthyer në hollësi që do të mundësonin shqyrtimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve të transportit midis Kosovës dhe BE-s. Mirëpo, është i mundshëm një përaftrim, që shqyrton informata të tjera në dispozicion, të mbledhura në intervistat me firmat transportuese të Kosovës. Shërbimet e transportit të Kosovës përballen me disa sfida të rëndësishme. Kompanitë që merren me transaksione të tregtisë së transportit të mallrave me shtetet anëtare të BE-s pretendojnë se kohë pas kohe nevojiten leje të posaçme për të transportuar në vende që nuk i njohin licencat e lëshuara nga Kosova, por kompanitë e Kosovës kryesisht shfrytëzojnë kompanitë ndërmjetëse serbe dhe maqedonase. Nevoja për kompani ndërmjetëse regionale është një disavantazh për tregtinë e shërbimeve të transportit të Kosovës me BE-n, sepse shpenzimet dhe të ardhurat nuk regjistrohen as në të dhënat e tregtisë së shërbimeve të Kosovës, dhe as në të dhënat e BE-s. Greqia bën përjashtim sepse kompanitë transportuese të Kosovës nuk kanë nevojë për leje të posaçme për të transportuar atje. Përveç kësaj, kompanitë kosovare përfitojnë nga tregu i brendshëm i BE-s në transportin tokësor të mallrave.

Sa i përket transportit tokësor të udhëtarëve, për shkak të mosnjohjes së pasaportave të Kosovës nga disa vende të BE-s, është e pamundur ose shumë e vështirë për kosovarët që direkt të hyjnë në BE nga Kosova. Prandaj, transporti direkt i udhëtarëve nga Kosova drejt vendeve të BE-s që nuk e njohin Kosovën është inekzistent, me përjashtim të Greqisë. Qytetarëve kosovar mund t'u jepet leja për të udhëtuar në Greqi. Sipas kompanive transportuese, transporti tokësor i udhëtarëve zhvillohet sidomos me vendet ku kryesisht jeton diaspora kosovare.

Sa i përket transportit ajror, Kosova shërbehet me transportues të huaj në mungesë të një kompanie ajrore kombëtare. Ajo tërësisht varet nga shërbimet e importuara. Vlera e shënuar si eksporte të shërbimeve të transportit ajror të Kosovës paraqet shërbimet që ofrohen në Kosovë për transportuesit e huaj. Sipas të dhënave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit (MIM),

kompanitë e BE-s për shërbime të transportit ajror, që operojnë në Kosovë janë nga Gjermania, Austria, Sllovenia, Norvegjia, Greqia, Belgjika, Hungaria, Danimarka dhe Suedia. Kjo pjesërisht e shpjegon tregtinë e shërbimeve të transportit ajror me këto vende anëtare të caktuara të BE-s.

Tregtia e shërbimeve të transportit me shtetet anëtare të BE-s, të cilat nuk kanë transportues që i shërben Kosovës dhe nuk ka transport të drejtpërdrejtë tokësor, mund të ndihmohet me shërbimet e transportit ndihmës dhe shërbimet tjera të transportit mbështetës dhe ndihmës.


Për sa i përket transportit detar, kompanitë transportuese kosovare raportojnë se atyre u lejohej të importojnë vetëm nga porti i Shqipërisë, por të mos e shfrytëzojnë atë edhe për eksport. Mirëpo, kompanitë kosovare të transportit përfitojnë gjithashtu nga E drejta Ndërkombëtare e Detarisë me dërgimin e produkteve nga aeroportet e Shqipërisë në vendet anëtare të BE-s, duke shfrytëzuar kryesisht kompanitë ndërmjetëse si në rastin e dërgesës në Spanjë, kryesisht me kompani ndërmjetëse serbe dhe maqedone. Mirëpo, ngjashëm me transportin tokësor, këto transaksione të veçanta nuk janë regjistruar në Bilancin e Pagesave të Kosovës, por në atë të shtetit, ku është regjistruar kompania ndërmjetëse.

3.1.3 Shërbimet e Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK)

Sektori i Shërbimeve të Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK) është shfaqur kohët e fundit si një sektor shumë i rëndësishëm dhe në rritje i ekonomisë së Kosovës. TIK-u është kryesisht modaliteti 1 i ofertës së shërbimeve dhe ai përfshin shkëmbimet ndërkufitare. Shërbimet TIK përbëhen nga tri nën-kategori: E para, shërbimet e telekomunikimit: të cilat janë emetimi ose transmetimi i tingujve, imazheve, të dhënave apo informatave të tjera përmes telefonit, teleksit, telegramit, transmetimit kabllor ose satelitor radio dhe televiziv, postë elektronike, faksimil e kështu me radhë, përfshirë shërbimet e rrjetit afarist, telekonferencat dhe shërbimet mbështetëse. E dyta, shërbimet kompjuterike që përfshijnë shërbimet që lidhen me harduer/softuer dhe përpunimin e të dhënave. Në fund, shërbimet informative, të cilat përfshijnë shërbimet e agjencive të lajmeve, siç është ofrimi i lajmeve, fotografive dhe kryeartikujve tek mediat. Shërbimet tjera për ofrimin e informacionit përfshijnë shërbimet e bazës së të dhënave – konceptimin e bazës së të dhënave, ruajtjen e të dhënave dhe shpërndarjen e të dhënave dhe bazave të të dhënave, si në internet, ashtu edhe përmes mediave magnetike, optike ose të shtypura; dhe portalet për kërkim në internet. Në këtë kategori përfshihen edhe abonimet e drejtpërdrejta jo-masive në gazeta dhe revista periodike, qoftë me postë, transmetim elektronik ose mjete të tjera; përmbajtje tjera në internet.

Kosova në këtë llogari varet nga tregtia me botën. Nuk ka të dhëna të grupuara për tregtinë me BE-n në kategori të ndryshme të shërbimeve të telekomunikimit, informacionit dhe kompjuterëve. Mirëpo, mbizotëron tregtia e përgjithshme në shërbimet e telekomunikimit me botën, duke përbërë 72.9 përqind të eksporteve totale dhe pothuaj 80 përqind të importeve totale të këtyre shërbimeve. Shërbimet e informacionit dhe kompjuterëve të Kosovës janë shfaqur si sektor premtues në vitin 2018, ndërsa shërbimet e informacionit në Kosovë nuk janë shumë të zhvilluara.

Kosova varet nga eksporti në transaksionin e tregtisë në TIK me BE-n. Eksportet e shërbimeve të telekomunikimit, informacionit dhe kompjuterëve të Kosovës me BE-n kanë arritur në EURO 26.8 milion në vitin 2018, duke pësuar rritje prej EURO 7.1 milion krahasuar me vitin 2017. Pra, ndryshe nga viti 2017, ku Kosova ka shënuar deficit tregtar prej EURO 4.5 milion në tregtinë e shërbimeve TIK me BE-n, Kosova ka shënuar një suficit tregtar në këtë llogari, prej EURO 7.1 milion në vitin 2018. Kjo ndodhi për shkak se Kosova ka pësuar rënie në importe në vitin 2018, nga llogaria prej EURO 4.5 milion.



Skica 6: Tregtia e Kosovës në shërbimet e Telekomunikimit, Informacionit dhe Kompjuterëve (TIK) me shtetet anëtare të BE-s dhe Mbretërinë e Bashkuar, 2017-2018. Burimi: EUROSTAT

Edhe në shërbimet TIK mund të veërehet një përqendrim i lartë i tregtisë nga shteti anëtar i BE-s. Kosova kryesisht tregon me Gjermaninë në shërbimet TIK, duke shlnuar bilancin më të lartë pozitiv me BE-n, të tregtisë në këtë veprimtari të shërbimeve. Në vitin 2018, Kosova ka shënuar EURO 12.2 milion në eksporte në Gjermani, duke pësuar rritje prej EURO 4 milion krahasuar me vitin 2017.

Kosova vazhdon të varet nga importi i shërbimeve TIK me MB-n, mirëpo, deficitin tregtar ka rënë, për shkak të një rritjeje pozitive në eksporte, e pasuar nga një rritje e njëkohshme në importe në vitin 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2017, ku shfaqet një tendencë pozitive në avancimin e Kosovës në shërbimet TIK. Eksportet e Kosovës në shërbimet TIK me MB-n kanë shënuar EURO 2.0 milion në vitin 2018, duke shënuar një rritje prej EURO 0.2 minë vitin 2017. Derisa importet e Kosovës në shërbimet TIK me MB-n kanë rënë për EURO 1.7 milion në vitin 2018, që përbën një shumë prej EURO 3 milion.

Është interesante të shihet se si tregtia e Kosovës në shërbimet TIK me Irlandën është paraqitur kohëve të fundit, e cila ka shënuar URO 2.5 milion në eksportet e shërbimeve TIK në vitin 2018, ndërsa në vitin 2017 Kosova ka importuar vetëm EURO 0.2 milion, por nuk ka eksportuar në Irlandë. Kjo shfaqje e shërbimeve TIK ka mundësuar shënimin e një bilanci pozitiv prej EURO 2.1 milion me Irlandën.

Kosova ka edhe një suficit të konsiderueshëm në shërbimet TIK me Slloveninë, por, tregtia ka rënë në dëm të Kosovës. Eksportet e Kosovës në tregtinë e shërbimeve TIK me Slloveninë ka rënë për EURO 0.5 milion në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, duke shënuar EURO 2.3 milion. Importet janë rritur për EURO 0.1 milion, duke shënuar EURO 0.6 milion në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017.

Deficiti tregtar në shërbimet TIK me Francën ka rënë në vitin 2018, krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin 2017, por ky nuk është një implikim në përmirësimin e tregtisë në dobi të Kosovës. Kosova ka ndryshuar drejtimin e saj në tregti, duke ulur shumën e shërbimeve TIK me Francën, por duke vazhduar të mbetet e varur nga importet. Eksportet e shërbimeve TIK në Francë kanë rënë për EURO 2.0 milion në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, duke bërë që Kosova të shënojë vetëm EURO 0.1 milion më eksporte. Edhe importet nga Franca në Kosovë janë ulur në EURO 1.0 milion në vitin 2018, me EURO 2.6 milion më pak se në vitin 2017.

Shërbimet TIK janë një sektor në zhvillim në Kosovë, i cili kontribuon në suficitin tregtar me BE-n në shërbime. Kosova duhet të investojë më shumë në zhvillimin e shërbimeve TIK duke pasur parasysh se ajo ka suficit në tregtinë me BE-n në këtë sektor. Mungesa e të dhënave të zbërthyer në kategori në shërbimet TIK kufizon analizën në arritjen e konkluzioneve të veçanta sa i përket nevojave të sektorit. Është me rëndësi se janë bërë përpjekje për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave të zbërthyer në kategori të tregtisë në këto veprimtari të rëndësishme, të cilat duket të jenë premtuese për Kosovën.


3.1.4 Shërbimet Tjera Afariste

Tregtia e shërbimeve tjera afariste është në masë të madhe modaliteti 4 i ofertës së shërbimeve, e cila kërkon dy parakushte: qasjen në territor, pra lëvizja e liberalizuar e personave fizik; dhe njohjen e kualifikimeve profesionale. Kjo llogari shënon eksportet dhe importet e një sërë shërbimesh të tregut, siç janë, ndërmjet tjerash shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit, këshilluese profesionale dhe menaxhuese, shërbimet teknike, shërbimet që lidhen me tregti dhe shërbimet e tjera afariste. Ky sektor është ndër sektorët më dinamik në tregtinë e shërbimeve në mbarë botën dhe për këtë arsye është shumë me rëndësi të përqendrohemi dhe të përmirësojmë më tej performansën e këtij sektori në Kosovë. Tregtia e këtyre shërbimeve ka treguar një dinamizëm të rëndësishëm në Kosovë, si në eksporte, ashtu edhe importe.

Tregtia e “shërbimeve të tjera afariste” ka një peshë të konsiderueshme në tregtinë e përgjithshme të shërbimeve të Kosovës me botën. Importet e këtyre shërbimeve janë të tretat për nga vlera, ndërsa eksportet janë veprimtaritë e dyta më të mëdha të shërbimeve në vend. Importet totale janë në rritje me një ritëm më të shpejtë se eksportet graduale, të cilat ulin suficitin tregtar që e ka pasur vendi. Sipas të dhënave për vitet 2017 dhe 2018, situata e tregtisë me BE-n tregon një model ndryshe. Në vitin 2018, Kosova ka shënuar rreth EURO 76.4 milion në eksporte me vendet e BE-s, Euro 25.7 milion më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Importet janë rritur në këtë sektor gjatë vitit 2018, krahasuar me vitin 2017, mirëpo shumë më pak se eksportet. Në vitin 2018, Kosova ka shënuar Euro 27.5 milion në importe të shërbimeve të tjera afariste me BE-n, vetëm EURO 7 milion më shumë se në vitin 2017. Kjo ecuri mundësoi rritjen e suficitit tregtar në tregtinë me BE-n për EURO 18.7 milion.

Siç është rasti me tregtinë e shërbimeve të ndryshme, ka përqendrim të lartë edhe të tregtisë me vendet anëtare të BE-s, e cila është prezente edhe në shërbimet e tjera afariste, siç mund të shihet në skicën 8. Të dhëna të hollësishme për shërbimet e tjera afariste me BE-n mund të gjenden në Tabelën 8 në shtojcë.

Shërbimet tjera afariste janë sektor i ri në tregtinë e shërbimeve të Kosovës me BE-n dhe nënshkrimi i marrëveshjes për njohje reciproke të kualifikimit profesional mund të jetë potencialisht në dobi të tregtisë së Kosovës me BE-n në këtë sektor. Neni 56 i MSA-s parashikon që negociatat për një marrëveshje të tillë të fillojnë brenda dy viteve nga hyrja në fuqi. Për më tepër, MSA-ja parashikon gjithashtu që brenda gjashtë vjetëve nga hyrja në fuqi, lëvizja e lirë e personave fizik që kanë lidhur kontrata bona fide për të ofruar shërbime, do të kenë qasje në tregjet e palëve.



Skica 7: Tregtia e shërbimeve të tjera afariste të Kosovës me shtetet anëtare të BE-s (përfshirë MB), në 2017- 2018. Burimi: EUROSTAT

Tregu kryesor i eksporteve për këto shërbime në BE për Kosovën është Gjermania, e cila në vitin 2018 ishte destinacioni i 32.2 përqind të eksporteve totale në BE. Në vitin 2018, eksportet u rritën për EURO 7.3 milion, krahasuar me vitin 2017, që përbëjnë EURO 26.4 milion në vitin 2018. Edhe importet kanë pësuar rritje, por me sasi më të ulët, krahasuar me rritjen në eksporte. Në vitin 2018, Kosova ka shënuar EURO 3.5 milion në importet e shërbimeve të tjera afariste nga Gjermania, EURO 1.4 milion më shumë se në vitin 2017. Kjo ka rritur suficitin tregtar për EURO 5.9 milion më shumë në vitin 2018. Eksportet e shërbimeve të tjera afariste në Gjermani do të mund të përmirësohen edhe më tej për shkak të Aktit të ri gjerman për Emigracion të Kualifikuar, i cili hyn në fuqi në mars të vitit 2020, i cili i mundëson secilit të shkojë dhe të punojë në Gjermani, pa pasur paraprakisht leje të punës. Destinacion tjetër i eksporteve të Kosovës është Austria, Irlanda, Bullgaria, Belgjika, Polonia dhe MB-ja, të cilat së bashku përfaqësojnë 37 përqind të të gjitha eksporteve të këtyre shërbimeve të Kosovës.

Shërbimet tjera afariste janë sektor shumë i rëndësishëm për tregtinë e Kosovës me BE-n. Përkundër se nuk ekziston marrëveshja për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, Kosova ka pësuar një suficit tregtar në shërbimet e tjera afariste me BE-n. Kjo tregon rëndësinë e investimit në këtë sektor duke përmirësuar sistemin arsimor, akreditimin profesional dhe duke nxitur marrëveshjet për njohje reciproke me BE-n. Politikbërësit e Kosovës duhet të bëjnë një analizë të tregut, e cila bën dallimin e nevojave vendore dhe ndërkombëtare të profesionistëve dhe rekomandon strategji për plotësimin e mangësive.

3.1.5 Konkluzionet dhe Rekomandimet për Drejtimin e Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës me BE-n

Kosova qëndron shumë mirë në tregtinë e shërbimeve me BE-n, me suficit tregtar prej EURO 766.8 milion në vitin 2018, EURO 4.5 milion më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2017. Duke pasur parasysh se Kosova historikisht ka deficit tregtar në tregtinë e mallrave, sektori i shërbimeve është aktualisht shtylla e ekonomisë.

Në shkëmbimet tregtare të shërbimeve të udhëtimit me BE-n vërehet përqendrim i lartë sipas kategorisë dhe vendit. Sektorët e shërbimeve kryesore të cilat i tregton Kosova me shtetet anëtare të BE-s përfshijnë shërbimet e udhëtimit, transportit, shërbimet tjera afariste dhe ato TIK. Kosova kryesisht tregton shërbimet me vendet anëtare të BE-s me frekuencën më të lartë të madhe të qëndrimit në diasporë. Këtu përfshihen kryesisht Gjermania, Italia, Austria, Franca, dhe Belgjika. Kjo nënkupton se qeveria e Kosovës duhet të investojë më shumë në tregtinë e shërbimeve për të avancuar dhe zgjeruar këtë sektor të ekonomisë, pa varshmëri të besnikërisë së diasporës.

Udhëtimi është shtylla e sektorit të shërbimeve, i cili kontribuon shumë në suficitin e tregtisë së shërbimeve. Arsyeja kryesore e transaksioneve të tregtisë së shërbimeve të udhëtimit është besnikëria e diasporës ndaj Kosovës. Qeveria e Kosovës duhet të rris investimet e saj në mënyrë që të krijojë turizmin tradicional në Kosovë, duke e hartuar së pari strategjinë kombëtare për turizëm.

Kosova ka pasur deficit në shkëmbimet e tregtisë së transportit me BE-n, mirëpo ky sektor është shumë i rëndësishëm për shkak të ndërlidhjes së tij me tregtinë e mallrave. Kompanitë kosovare merren me të gjitha format e shërbimeve të transportit, megjithatë jo të gjitha regjistrohen në Bilancin e Pagesave për shkak të shfrytëzimit të komanive ndërmjetëse.

Shërbimet TIK duhet të merren parasysh për politikbërje të ardhshme, për shkak të kontributit të tyre në suficitin tregtar me BE-n.

Shërbimet tjera afariste janë gjithashtu një sektor i ri në tregtinë e shërbimeve me BE-n, sepse Kosova ka gjithashtu suficit tregtar në këtë sektor dhe krijimin e bazës për negociata të ardhshme me BE-n sa i përket njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale dhe lëvizjse së lirë të përkohshme të personave fizik, në përputhje me MSA-n.

3.2 Tregtia e Kosovës në Nën-sektorët e Shërbimeve Kryesore me Palët e CEFTA-s

Kjo pjesë analizon shkurtimisht tregtinë e shërbimeve të Kosovës me vendet e CEFTA-s. Tregtia e shërbimeve është bërë e rëndësishme në kuadër të CEFTA-s. Vendet e CEFTA-s u angazhuan në negociata për liberalizim të tregtisë së shërbimeve, të cilat mundësuan nënshkrimin e PSH 6, i cili u miratua në dhjetor të vitit 2019. Kosova me PSH 6 është zotuar për liberalizim të tregtisë për një numër të konsiderueshëm të kategorive të shërbimeve. Ky protokoll vlen vetëm për vendet e CEFTA-s. PSH 6 përfshin një spektër të gjerë të sektorëve të shërbimeve bazuar në GATS të OBT-s.

Tabela Nr.1 paraqet të dhënat e tregtisë së shërbimeve midis Kosovës dhe secilës nga palët e CEFTA-s. Në vitin 2018 tregjet e CEFTA-s ishin destinacion i përafërsisht 5.7 përqind të eksporteve totale të shërbimeve dhe origjinë e rreth 26 përqind të importeve totale. Kosova shënon një deficit të përgjithshëm tregtar në tregtinë e shërbimeve me anëtarët e CEFTA-s. Ka suficit në tregtinë e shërbimeve vetëm me Serbinë gjatë periudhës nën shqyrtim. Në vitin 2018 eksportet janë rritur për 24 përqind, ndërsa importet u rritën për 22 përqind, duke e shtuar deficitin tregtar për 20 përqind. Edhe pse eksportet ende nuk janë thelbësore, CEFTA mund të konsiderohet si një destinacion strategjik për tregtinë e shërbimeve. Të dhënat e detajuara sipas kategorisë së shërbimit mund të gjenden në Shtojcë. Ajo përfshin disa shërbime të pashtjelluara në këtë raport.

Tabela Nr. 1: Tregtia e Shërbimeve me CEFTA-n sipas vendit 2017-2018 në milion euro

	Eksporti	Importi	Bilanci	Eksporti	Importi	Bilanci
Vendi/Viti	2018			2017		
Shqipëria	54.896	178.73	-123.834	18.01	140.58	-122.57
Bosnja dhe Hercegovina	1.523	4.25	-2.727	16.89	5.17	11.72
Maqedonia Veriore	9.48	26.55	-17.07	4.35	15.10	-10.75
Moldavia	0.372	0.07	0.302	0.38	0.06	0.33
Mali i Zi	7.034	18.63	-11.596	8.92	14.88	-5.95
Serbia	15.566	8.15	7.416	18.39	8.98	9.41
Totali	88.871	236.38	-147.509	66.94	184.76	-117.83

